

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1820 Prot.  
/6

Patos më 24.07.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 18.07.2024

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 në orën 11:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Armand Ahmetaj
2. Zejni Musaj
3. Novrus Toska
4. Vjollca Kasaj
5. Suela Hoxha
6. Eduart Faslliaj
7. Enkelejda Ajazi
8. Erald Çepele
9. Ertilla Myrtaj
10. Klaudio Alisininaj
11. Renaldo Shpata
12. Smerald Hazizaj
13. Artan Velçani

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përhëndetje të gjithëve! Të nderuar këshilltarë, të nderuar qytetarë! Zhvillojmë këtë mbledhje në zbatim të nenit 53 pika 4 të nenit 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore dhe rendi i ditës i cili është miratuar për tu diskutuar ditën e sotme është

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.06.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.06.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Qershor 2024”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Qershor 2024”
- 6- Projekt-vendim “Mbi miratimin e Tavaneve Përfundimtar të Programit Buxhetor 2025-2027”.

- 7- Projekt-vendim "Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".
- 8- Informacion mbi ristukturimin e Këshillit Vendor Rinor (KVR).


Para se të kalojmë në diskutimin e rendit të ditës dua tju njoftoj që me kërkesë të ekzekutivit të heqim nga rendi i ditës pikën shtatë Projekt-vendim "Për disa ndryshime në lidhjen nr. 3 dhe 4 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024", për arsye se ende nuk janë transferuar fondet për të përballuar këto paga. Pra në momentin që do të transferohen fondet kalojmë në vendim të këshillit.

Po ashtu brenda kësaj kërkesë është dhe shtimi i një pike në rendin e ditës "Projekt vendim për miratimin e transferimit të fondit midis programeve dhe projekteve për investime". Të dyja këto parashikohen në nenin 64 të rregullores. Pra do të kërkoja miratimin tuaj për të hequr pikën shtatë nga rendi i ditës dhe për të shtuar si pikë tetë pikën që sapo prezantova "Projekt vendim mbi miratimin e transferimit të fondit midis programeve dhe projekteve për investime". Kush është dakord me rendin e ditës me ndryshimet e propozuara?


- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.06.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.06.2024.
- 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Qershor 2024".
- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Qershor 2024".
- 6- Projekt-vendim "Mbi miratimin e Tavaneve Përfundimtar të Programit Buxhetor 2025-2027".
- 7- Informacion mbi ristukturimin e Këshillit Vendor Rinor (KVR).
- 8- Projekt vendim "Mbi miratimin e transferimit të fondit midis programeve dhe projekteve për investime".

Kush është dakord për miratimin e rendit të ditës me ndryshimet e propozuara?  
Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



KRYETAR  
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1828 / 7 Prot.

Patos më 24 .07.2024

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.


Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.06.2024.

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjërim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje ose sygjërim në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar unanimisht procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1826 Prot.

8

Patos më, 24 07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 28.06.2024

Armand Ahmetaj- Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba- Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 28.06.2024 janë marrë gjithsej 3 vendime. Vendimi nr. 50, nr. 51 dhe 52.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime asnjë nuk shkoj në Prefekturë pasi nuk e parashikonte ligji.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1858 / Prot.  
13

Patos më 24 .07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2024”.

Armand Ahmetaj- Dua t’ju njoftoj se në zbatim të rregullores është mbledhur komisioni i Ekonomisë në datën 16.07 dhe e ka shqyrtuar këtë pikë dhe e ka kaluar për shqyrtim në mbledhjen e këshillit me tre vota pro.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim? Nëse nuk keni unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt

Atëherë kalojmë në votim. Kush është dakord për pikën e katërt? Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2024”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 18571 Prot.  
13

Patos më 24 07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2024”.

Armand Ahmetaj– Po e njejta gjë dhe për këtë pikë komisioni është mbledhur, e ka kaluar për diskutim në këshill me tre vota pro.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim? Nëse nuk keni unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1825/ Prot.  
3

Patos më 24 .07.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “ Projekt-vendim “Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtar të Programit Buxhetor 2025-2027”.

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit.

Mimoza Shtëmbëri-Drejtoreshë e Financës, Përsëritje të gjithëve! Projekt-vendimi “Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm është një projektvendim që vjen në vazhdim të gjithë fazave të përgatitjes dhe finalizimit të projektbuxhetit afatmesëm dhe vitit të parë buxhetor për këtë PBA që është viti 2025. Në këtë fazë kemi sjell për miratim tavanet përfundimtarë të Programit Buxhetor Afatmesëm të cilat janë burimet dhe shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik të pandryshuara. Kemi vetëm miratimin e shtatëmbëdhjetë programeve dhe ndryshim të tavanëve midis dy, tre programeve, brenda llogarive ekonomike. Që do të thotë shpenzimet e personelit nuk kanë ndryshuar, shpenzimet operative nuk kanë ndryshuar shpenzimet kapitale nuk kanë ndryshuar nga miratimet që keni bërë, thjesht kanë ndryshuar tavanet duke bërë pasqyrimin e drejtë midis programve të objekteve për investime. Dhe ndryshime të tjera nga dokumenti i parë i PBA-së nuk ka. Relacioni e shpjegon më saktë, është i detajuar ku pasqyrohen saktë burimet dhe shpenzime të cilat janë të pandryshuara me fazën e parë të hartimit të dokumentit të parë si dhe klasifikimi ekonomik i pandryshuar.

Eduart Faslliaj- Shoh që kemi në parashikimin e tavanëve të ardhura taksa mbi tokën bujqësore. Ka një rritje me mbi 100 % e ca përqind nga viti 2023 në vitin 2024. Edhe kjo e parashikuara dhe kjo e rishikuara ka ngelur në të njëjtën vlerë. Ka qënë nëntë milion e ca dhe ka shkuar njëzetë e një pikë katër. Dua të di që kush është arsyeja, ku e keni mbështetur këtë rritje mbi njëqind e ca përqind të mbledhjes së taksës mbi tokën bujqësore? Unë nuk shikoj se ka ndonjë rritje të numrit të taksapaguesve, apo ndonjë investim madhor.

E dyta- Taksa e ndikimit në infrastrukturë po ashtu ka një rritje dhe është e parashikuar për të katërt vite nga viti 24 dhe mbrapa. Nga 1 milion e 100 mijë ka shkuar në 7 milion. Po kështu dhe tarifa e menaxhimit të mbetjeve. Dua të di se ku e keni bazuar këtë rritje? Tarifa e menaxhimit të mbetjeve ka qënë 25 milion dhe ka shkuar 42, dhe një sqarim tjetër kemi këtu tarif parkimi ka një vlerë të caktuar, kemi në parkim me pagesë?

Mimoza Shtëmbëri- Taksa e ndikimit në infrastrukturë është bërë një rishqyrtim i detyrimeve që ka pasur në analizë edhe nga rekomandimet e KLSH-së dhe është studiuar që të vij me rritje në tre vitet në vazhdim.

Kryetari i Bashkisë- Taksa e ndikimit në infrastrukturë përveç ndryshimit që janë tek pjesa e tavanëve buxhetore ka dhe një numër shumë të madh të taksës së ndikimit në infrastrukturë që nuk është paguar, është në nivele të larta. Ne kemi filluar, kemi marrë masa për pagesën e ndikimit në infrastrukturë duke filluar dhe nga objektet që janë në proces legalizimi që duhet të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë që kanë në bashki dhe pastaj të vazhdojnë me procedurën që i takon bashkisë për të dhënë informacion në Agjencinë Shtetërore të Kadasrës. Për pjesën e taksës së tokës bujqësore unë nuk mund të them dot tani por ne kemi bërë dhe një riinventarizim të të gjitha parcelave bujqësore që janë në bashkinë e Patosit të cilën e kemi mbyllur para disa ditësh dhe ka disa ndryshime tek pjesa e tokës bujqësore.

Për pjesën e vlerës le të flasi Drejtori i Taksave për taksën bujqësore por që ka lëvizje. Kjo ndikon dhe fakti që një pjesë e tyre janë certifikuar si tokë bujqësore dhe normalisht në momentin që janë certifikuar është më e kontrollueshme dhe pagesa për taksën bujqësore.

Çajup Refitaj- Drejtori i të Ardhurave Vendore- Pavarsisht se sipërfaqet nuk kanë ndryshime por hera herës ne parashikojmë, domethënë i referohemi si parashikim jo duke parë rritjen se nuk kemi parashikuar rritje të taksës për tokën bujqësore por thjeshtë janë para parë rastet kur mund të kemi sipërfaqe që na vijnë për shkak të certifikimeve të tjera me radhë që mund të shtohen për arsye dokumentacioni. Me pak fjalë rritet baza e taksueshme. Kjo parashikohet gjithmonë. Nuk kemi parashikuar që në vitet në vazhdim të këtë rritje.

Eduart Faslliaj- Meqë ishim këtu kryetar ka një problematik tek toka bujqësore që është e mbartur ndër vite. Marrë shkas nga Margëlliçi por po ju kujtoj dhe disa fshatra të tjerë të cilët kanë aplikuar. Sepse ligji 7501 në këto dy ndoshta në Rusinjë ka qënë me problematika të mëdha, bazuar mbi një ligj që nxori qeveria ku qytetarët kanë bërë aplikime, këta që kanë qënë informal, kanë bërë aplikime për tu bërë legal. Kemi bërë aplikime këtu pranë Drejtorisë së Bujqësisë. Në informacionin tim që kur kemi qënë para 8-vjetësh janë çuar në Kadastrën e Qarkut dhe nga ai moment dhe deri tani nuk kemi ndonjë informacion se çfarë po ndodh me certifikimin e kësaj toke bujqësore sepse në këtë rast ne nuk mbledhim as taksën. Unë jam një nga banorët që kam këtë lloj problematike dhe në dijeninë time në fshatin Margëlliç mund të jenë 70-80 % e banorëve. Bashkia nuk mbledh dot taksën, banorët nuk e japin sepse nuk e kanë pronën. E kanë de facto por se kanë de jure dhe çfarë po ndodh me dokumentacionin? Kur do ketë një fund kjo gjëja që Bashkia të mari taksën por dhe qytetari të mari pronën? Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë- Kjo nuk varet nga bashkia. Kjo varet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Ne kemi kërkuar informacion vazhdimisht dhe për zonat që nuk janë të azhornuara. Ne kemi bërë gjithmonë kërkesë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës që të vazhdojnë me azhornimin e tyre por duke qënë se në shtator do këtë një rol vendimarrës në këtë proces , hap pas hapi mund të shkohet dhe në pjesën tjetër dhe pjesa tjetër. Pra në shtator do te jemi më të qartë, sepse në shtator do të futet dhe bashkia tek pjesa e legalizimeve.

Eduart Faslliaj- Për tokën bujqësore them unë që të vjelim taksën.

Kryetari i Bashkisë- është një gjë që nuk varet nga bashkia tek toka bujqësore

Eduart Faslliaj- Ok por do të ngeleni pa taksa.

Kryetari i Bashkisë- Normalisht paguhet taksa dhe pa pasur certifikatë.

Eduart Faslliaj- Ju po merni taksën pa patur pronën?

Kryetari i Bashkisë-Ne mund të marim pronën vitin tjetër prandaj parashikohet rritja e taksës bujqësore se ne ecim sikur do bëhët por besoj se do marin zgjidhje.

Eduart Faslliaj- Urojmë! Do bëj certifikim bashkia apo jo kjo është ideja se kanë tetë vjet që kanë dorzuar dokumentacionin?

Kryetari i Bashkisë- Kjo varet nga Drejtoria e Kadastrës.

Erald Çepele- Një korigjim të vogël kisha unë tek tabelat e PBA-së 2025-2027. Unë nuk shikoj rritje të tarifave apo të të ardhurave nga kjo pjesë psh tokën bujqësore. Toka bujqësore fakti është njëzet e një milion e katërqind e njëzet e një mijë dhe 24 edhe 25 edhe 26. 2022 dhe 2023 këtu është plan dhe plani është realizimi patjetër. Fakt më fal, ky është fakti kështu që nuk kemi rritje ne këtu se po të krahasonin planin e 2023 me 2024 mund të thoshnim që ka rritje. Kurse faktin ne e kemi vërtet njëzet e një milion e katërqind e njëzet mijë por fakti kaq mund të vej nëntë milion e tetëqind aq sa e ke patur në 2023. Kështu që nuk shoh ndonjë rritje këtu.

Çajup Refitaj- Plani ka të bëj me pjesën e arkëtuar.

Erald Çepele- Unë dua planin e 2023 të shikoj nuk e kemi sa ka qënë plani që të themi sa është rritur, kemi fakt plan. Faktin e 2024 do ta shikojmë në fund sa do dali. Mund të realizohen dhe më pak të ardhura.

Mimoza Shtëmbari- Tabelat që shoqërojnë buxhetin afatmesëm janë standarte të miratuara nga Ministria e Financave.

Erald Çepele- Ne kemi rritje në planifikim?



Mimoza Shtëmbari- Po kemi rritje në planifikim, në monitorim e kemi raportur që realizimi është 78% dhe kjo rritje është 100% pra kemi rritje.

Artan Velçani – Tek fjala e Eduartit u duk sikur rritja e të ardhurave për buxhetit afatmesëm ose kështu e kuptova unë vinte nga fakti që janë rritur tarifat dhe taksat. Në fakt Çajupi e shpjegoi shume mirë që nuk kemi të bëjmë me rritje të vlerës për shkak të rritjes së tarifave dhe taksave. Dua t’ju rikujtoj se këto merrem me vendim të posacëm të këshillit bahkiak. Një herë në vit para se të miratohet buxheti miratohet dhe paketa fiskale. Por është rritur numri i personave që janë të detyruar të paguajnë taksat dhe tarifat. Faleminderit!


Armand Ahmetaj – Kemi ndonjë diskutim tjetër ? Nëse nuk keni unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtar të Programit Buxhetor 2025-2027”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1823 Prot.  
11

Patos më 24 .07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Informacion mbi ristukturimin e Këshillit Vendor Rinor (KVR).

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit.

Ekzekutivi – Elda Goxhaj- drejtore e Integritimit European, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve relatton materialin e paraqitur me shkrim.

Përshëndetje!

Në mbështetje të nenit 9, shkronja b, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 30.04.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ristukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të tij”, ju informojmë s pas miratimit të kriterëve dhe procedurave në Këshillin Bashkiak, bashkia Patos hapi thirrjen për aplikime për anëtarë të Këshillit Vendor Rinor në datë 13.05.2024 me afat kohor 10 (dhjetë) ditë nga dita e shpalljes së thirrjes.

Pas përfundimit të afatit për aplikim për anëtarë të Këshillit Vendor Rinor është ngritur urdhri nr. 99, datë 16.05.2024 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aplikimeve për anëtarët e Këshillit Vendor Rinor”, komisioni i përbërë nga anëtarë si më poshtë:

- |                   |         |
|-------------------|---------|
| - Iri Xhelaj      | Kryetar |
| - Simela Shahinaj | Anëtar  |
| - Fjona Çako      | Anëtar  |
| - Dajana Ndoj     | Anëtar  |
| - Nurkë Hazizaj   | Anëtar  |

Ky komision u mblodh në datë 30.05.2024 dhe shqyrtoi të gjitha aplikimet e dorëzuara pranë bashkisë duke respektuar afatin kohor prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e mbylljes së aplikimeve. Vlerësimi u realizua në bazë të gjithë dokumentacionit të kërkuar dhe dorëzuar nga aplikanti. Në total ishin 10 (dhjetë) aplikime të cilat rezultojnë sipas listës së mëposhtme:

- 1- Enxhi Bregu
- 2- Klejdi Mukaj
- 3- Sibora Ballaj

- 4- Xhoela Murataj
- 5- Sokol Baxhia
- 6- Pamela Kocaqi
- 7- Martina Gllavaj
- 8- Veip Kamberaj
- 9- Anxhela Mamo
- 10- Anxhela Tata

Bazuar në vlerësimin e komisionit të gjitha aplikimet e mësipërme përmbanin bazën e plotë të dokumentacionit sipas ligjit dhe shpalljes së njoftimit në faqen zyrtare të bashkisë. Komisioni rezultoi se aplikantët e mësipërm përmbushnin kriteret e thirrjes dhe mund të shpallen anëtarë të Këshillit Vendor Rinor (KVR).

Referuar pikës 3, të VKM-së nr. 969, datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtarë të Rinisë” pas përfundimit të mandatit të parë të KVR dhe pas vlerësimit të aplikimeve të reja, është ngritur edhe vendimit nr. 110, datë 03.06.2024 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, KVR”, i cili përmban emrat e anëtarëve të zgjedhur dhe disa pika lidhur me funksionimin e KVR.

Është zhvilluar dhe mbledhja e parë me KVR e re. Është miratuar dhe rregullorja se si do të funksionoi dhe KVR-ja. Deri në këto hapa procesi jemi.

Eduart Faslliaj- Nga sa anëtar është i përbërë KVR

Elda Goxhaj- 10(dhjetë).

Eduart Faslliaj- domethënë kishte 10(dhjetë) aplikime për 10(dhjetë) vende.

Cili është funksioni i forumit rinor?

Elda Goxhaj- Nuk kanë funksion vendimarrës, kanë funksion këshillues pranë Kryetarit të Bashkisë mbi çështje që ligjen me rininë.



Eduart Faslliaj- A ka anëtar që del nga këshilli rinor vendor për këshillin kombëtar dhe si përzgjidhen?

Elda Goxhaj- Këshilli kombëtar ka të njëjtat kritere. Unë po ju jap një informacion tjetër. Është duke u bërë një dëgjuesë publike në të gjithë Republikën e Shqipërisë për ndryshimin e ligjit për rininë. Sepse nga ligji për rininë është dhe mënyra e funksionimit për këshillin kombëtar dhe këshillave vendor. Është ligji duke u rishikuar. Në rastin e Patosit jo, mund të aplikojnë, janë të lirë por jo.

Armand Ahmetaj- Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1924 Prot.

Patos më 24.07.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.07.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt vendim “Mbi miratimin e transferimit të fondit midis programeve dhe projekteve për investime”.

Ermenita Mici – Përshëndetje të gjithëve!

Në buxhetin e vitit 2024 të miratuar me VKB nr. 81 datë 18.12.2023, është miratuar në kategorinë rrugë rurale, infrastrukturë projekti për “Rikonstruksionin e rrugës Gjinoqarë”, ky projekt është miratuar me vlerë prej 25,000,000 (njëzetë e pesë milion) lekë dhe ka një shtrirje kohore për realizimin e tij përgjatë dy viteve, që do të thotë fondi për këtë projekt është parashikuar të likujdohet pjesërisht në vitin 2024 dhe në vitin 2025 në vlerat e caktuara.

Nga rishikimi i projektit nga grupi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është parë më e domosdoshme si rrugë që bëhet fjalë në zonën rurale që ka një gjerësi që maksimumi varjon në 3 metër të ndërhyhet dhe të realizohet rikonstruksioni i paketës së shtresave rrugore. Në këtë mënyrë është hartuar dhe preventivi përkatës i cili gjendet bashkëlidhur kësaj lidhje dhe është përcaktuar vlera e ndërhyrjes si bazë materiale për rikonstruksionin e kësaj rruge. Vlera e preventivit është 6,500,000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë, e cila si vlerë do të shtohet fondit të parashikuar për shtimin e rrugëve me asfaltobeton. Pjesa tjetër e fondit që ngelet nga totali i parashikuar në buxhetin e vitit 2024 do të përdoret për investime në programin e arsimit.

Qëllimi i këtij ndryshimi është për shkak dhe të kërkesave të shumta të banorëve që kjo rrugë të realizohet sa më shpejt dhe ky investim me këtë lloj zgjidhje si bazë materiale do të shkurtoj periudhën e realizimit dhe do të shmang gjithë etapat nëse ky projekt do të realizohet me prokurim dhe gjithë fazat që vijnë nga ana ligjore. Për anën financiare do të flasi Drejtoresha e Financës.

Mmimoza Shtëmbari Drejtoresha e Financës - Nga ana financiare ky projektvendim kërkon për miratim transferimin e fondeve midis programeve dhe projekteve për investime dhe konkretisht kemi miratuar vlerën e projektit për rrugën Gjinoqarë me 25 000 000 (njëzetë e pesë milion) lekë me financim 2-vjeçar. 6 500 000 ( gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë është për vitin 2024 dhe diferenca është për vitin 2025. Kërkojmë të transferojmë 6 500 000 ( gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë të cilën e kemi buxhetuar për rikonstruksionin e rrugës Gjinoqarë, të bashkohet në programin e Shërbimeve Publike për blerje të asfaltobetonit për të mbuluar sipas preventivit që ka hartuar drejtorja e Shërbimeve ndërtimin e rrugës Gjinoqarë duke i ardhur më shpejt si Shërbim dhe me kosto më të ultë.

Pjesa për financimin e 2025 prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë kërkojmë ta transferojmë në programin e arsimit bazë në objektin shtim të vlerës "Rikonstruksion i kopshtit me drekë Patos", pasi kur është bërë planifikimi ka qënë projekt ide dhe tani është në fazën përfundimtare të projektimit dhe vlera është më e madhe. Dhe kjo vlerë i përket financimit për vitin 2025 i cili do të pasyrohet tek tavanet tek dokumenti përfundimtarë i PBA-së. Dhe 6 500 000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë financim për 2024 për këtë objekt dhe 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë që do të shtohet për arsimin bazë te rikonstruksioni i kopshtit me drekë do të pakësohet nga programi rrugë rurale, nga objekti rikonstruksion i rrugës Gjinoqarë. Në total transferimi është 23 500 000 (njëzetë e tre milion e pesëqind mijë) lekë. 6 500 000 (gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë do të kalojnë blerje asfaltobeton për të shtruar rrugën Gjinoqarë dhe 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë shtim të vlerës të projektit të kopshtit me drekë Patos. Transferimi nga ana financiare më këto kode projekti dhe kode programesh është sipas këtij projektvendimi.

Kryetari Bashkisë- Të sqaroj dhe për ato që pyetët pak më parë. Për 2023 plani për taksën mbi tokën bujqësore ka qënë 21 420 000 dhe realizimi ka qënë në vlerën 9 082 000 pra plani i 2023 ka qënë pothuajse sa është plani fillestar i 2024. Pra përfshin të gjitha tokat bujqësore që kemi ne. Dhe realizimi në 2023 ka qënë 40%. Në 2022 ka qënë diku 35%. E njejta gjë vlen dhe për taksën e truallit dhe për taksën e ndërtesës. Planu fillestar është pak a shumë sa 2024 por mund të ketë një rritje të vogël, ato që lexoje ti nuk ishin rritje ishin realizime. Dhe jemi dhe tek plani i tarifave të menaxhimit të mbetjeve.

Tarifava e menaxhimit të mbetjeve ka qënë e njejta vlerë sepse numri i qytetarëve nuk shtohet dhe nuk pakësohet. Këtu është fakti pra edhe tek taksa e menaxhimit të mbetjeve është e njejta vlerë ndryshon vetëm realizimi. 2022 -2023 ne kemi një rritje prej 7 000 000 lekë afërsisht. Kështu që nuk ka ndonjë ndryshim, plani ka qënë njejtë, thjesht këtu ke realizim.

Për pjesën e transferimit të fondit duke qënë se kopshti doli pak nga parashikimi normalisht fëmijët e meritojnë ta kenë një kopsht që të ketë standarte bashkëkohore. Projektpreventivi shkon në vlerën 46 - 47 që është parashikuar tek ndryshimi. Është parashikuar gjithë rikonstruksioni i kopshtit bashkë me ambjentet e jashtme të tij dhe lulishte dhe ambjente argëtuese për fëmijët. Edhe pjesa e brendshme ka rikonstruksion total bashkë me sistemin e ngrohjes dhe ftohjes.

Rruga e Gjinoqarës pas rishikimit në terren për të ndërhyrë në zgjerime të mëdha të rrugës, duke parë terrenin është pothuajse e pamundur. Pjesë mure mbajtës kishte disa ndërhyrje të vogla që ne mund ti bëjmë me Agjencinë e Shërbimeve Publike, ne do blejmë vetëm pjesën e bazës materiale. Rruga do bëhet po thjesht ndryshon mënyra e shtrimit të rrugëve. Nuk do bëhet më me operatorë por do bëhet nga vet bashkia. Dhe vlera ka goxha diferencë sepse dhe për pjesën e kanalizimeve të ujrave të ndotur donte një studim të mirëfilltë duke qënë se pjesa më e madhe e banorëve në Gjinoqarë janë me gropa skeptike. Ndërsa pjesa tjetër e investimit të Gjinoqarës do kaloj tek kopshti.

Projektpreventivi është përfunduar ne e çojmë për oponencë te Instituti Ndrimit. Ne do mendohemi që investimin ta vendosim brenda një kohe të shkurtër.

Erald Çepele- Unë kisha vetëm një korigjim. Te vendimi i këshillit bashkiak nr. 81 datë 18.12. ne kemi miratuar 25 000 000 fondin për rikonstruksionin e rrugës së Gjinoqarës. Tani 6 500 000 mijë do përdoren bazë materiale dhe 17 000 000 janë për kopshtin. I bie 23 500 000. Këto 1 500 000 mijë të tjera?

Mmimoza Shtëmbari- Nuk do transferohen. Janë brenda programit.

I kemi për rrugët rurale brenda programit të rrugëve rurale dhe do shtohet vlera e investimeve që është brenda programeve.

Eduart Faslliaj – Ky investimi i kësaj rruge përafërshisht 3 metërsh. Ne do bëjmë një punë të vogël krahasuar me atë çfarë kishim nisur në atë fshat. Një punë thuajse për emergjencë sepse atje ka nevojë për mure mbajtës, kanë nevojë për kanalizime që rruga të bëhet funksionale sepse rrugë kanë ata po nuk funksionon ashtu siç duhet.

Kryetari Bashkisë- Problemi i kanalizimeve nuk mund të marri kanalizimet e ujrave të ndotur dhe ti nxjerri 200 metër më poshtë nga rruga. Në momentin që atje nuk janë të rregulluara gjithë pjesa e kanalizimeve që të trajtohet është e kot që ti bësh.

Eduart Faslliaj – Po por duhet ti kishe parashikuar që kur parashikuat bërjen e rrugës.

Kryetari Bashkisë- Në zonat rurale janë të gjithë me gropa septike.

Eduart Faslliaj – Kur fillojnë punimet?

Kryetari Bashkisë- Brenda këtij viti besoj. Ne tani jemi duke bërë planifikimin për blerjen e bazës materiale dhe besoj nga fundi i muajit do ti kemi konkretizuar të gjithë gjërat, të nxjerim fiks gjatësitë e rrugës ku do të ndërhyhet.

Eduart Faslliaj – Do ti lini të zhgënjyer se bëtë gjithë ato dëgjesa publike.

Kryetari Bashkisë- Rruga do të bëhet përsëri. Do të mbyllet brenda muajit dhjetor. Gjithashtu relaton investimet që do të kryhen në disa rrugë.

Eduart Faslliaj – Kompania që po shtron ujësjellësin kur do të filloj me rehabilitimin e rrugëve?


Kryetari Bashkisë- Brenda 18 muajve rrugët do të bëhen ashtu si ishin.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim? Nëse nuk keni unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë “Mbi miratimin e transferimit të fondit midis programeve dhe projekteve për investime”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE  
Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

